



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 290, Datë 09.10.2023

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“ECO-ELB” SH.A. PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI I PËRPUNIMIT TË
MBETJEVE URBANE, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2850 KW**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, 10, pikat 1 dhe 3, si dhe 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 09.10.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 137/14 prot., datë 04.10.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “ECO-ELB” sh.a. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “ECO-ELB” sh.a. është mbajtëse e licencës për prodhimin e energjisë elektrike, licencuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 93, datë 28.04.2022 dhe rinovuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 142, datë 24.04.2023, me afat vlefshmërie deri më 27.03.2024. Më datë 27.09.2023, shoqëria ka paraqitur në ERE aplikimin për rinovimin e kësaj licence.
- Në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë, ndaj aplikimi i shoqërisë është paraqitur brenda këtij afati.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “ECO-ELB” sh.a. ka plotësuar dokumentacionin e përcaktuar në nenin 16, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; si dhe nenin 16, pika 7, të Rregullores.
- Shoqëria “ECO – ELB” sh.a., ka marrë në përdorim impiantin e incenerimit për të kryer aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike në mbështetje të kontratës së qirasë midis Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara dhe shoqërisë “ECO – ELB” sh.a. me nr. 1027, datë 10.03.2023, duke filluar afatin 1-vjeçar nga data 27.03.2023. ERE me vendimin e bordit nr. 142, datë 24.04.2023, e ka rinovuar licencën e shoqërisë “ECO-ELB” sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike në mbështetje të afateve të kësaj kontrate, pra deri më datë 27.03.2024. Aktualisht shoqëria disponon një kontratë të vlefshme qiraje, në vijim vlerësojmë se vendimmarrja e ERE-s për rinovimin e licencës së shoqërisë do të mbështetet mbi informacionin/dokumentacionin që do të depozitohet nga shoqëria në lidhje me rinovimin e kësaj kontrate.
- Aplikuesi ka kryer pagesën, sipas përcaktimeve të Aneksit A të Rregullores dhe nuk rezulton debitor për pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike, nga centrali i përpunimit të mbetjeve urbane, me kapacitet të instaluar 2850 kW, duke filluar nga data 28.03.2024.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “ECO-ELB” sh.a. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

Votimi i Bordit të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr. 290, Datë 09.10.2023

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“ECO-ELB” SH.A. PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI I PËRPUNIMIT TË
MBETJEVE URBANE, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2850 KW**

Anëtarët e Bordit

Pro

Kundër

Petrit Ahmeti

Erjola Sadushi

Maksim Shuli

Raimonda Islamaj

Petra Lika
